FLETORJA ZYRTARE
E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 97	2003	Dhjetor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9144 datë 27.10.2003	Për miratimin e Buxhetit Faktik të Shtetit të vitit 2002……	4199
Ligj nr.9147 datë 30.10.2003	Për ratifikimin e Konventës nr.155 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës "Për sigurinë në punë, shëndetin dhe mjedisin e punës, 1981"……..	4200
Ligj nr.9148 datë 30.10.2003	Për ratifikimin e Protokollit të vitit 2002 të Konventës nr.155 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës "Për sigurinë në punë, shëndetin dhe mjedisin e punës, 1981"……	4206
Ligj nr.9149 datë 30.10.2003	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8310, datë 19.3.1998 "Për sigurinë në aviacionin civil shqiptar"……	4210
Ligj nr.9150 datë 30.10.2003	Për Urdhrin e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë……	4213

L I G J
Nr.9144, datë 27.10.2003

PËR MIRATIMIN E BUXHETIT FAKTIK TË SHTETIT,
TË VITIT 2002

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 158 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Miratohet Buxheti Faktik i Shtetit, i vitit 2002 dhe burimet e financimit si më poshtë:

1. Buxheti i Shtetit

- Të ardhurat gjithsej……	124 840 milionë lekë;
- Shpenzimet gjithsej ……	165 960 milionë lekë;
2. Buxheti i sigurimeve shoqërore	
- Të ardhurat…….	35 603 milionë lekë;
- Shpenzimet ……	36 565 milionë lekë;
3. Buxheti i sigurimeve shëndetësore	
- Të ardhurat…….	3 645 milionë lekë;
- Shpenzimet…….	3 604 milionë lekë;
4. Deficiti buxhetor…….	42 041 milionë lekë;
5. Financimi i deficitit buxhetor……..	42 041 milionë lekë;
I brendshëm……..	21 394 milionë lekë;
A. Me instrumente financiare (kredimarrja e brendshme neto)……..	19 593 milionë lekë;
- Kredi nga Banka e Shqipërisë……	1 148 milionë lekë;
- Bono thesari……	17 443 milionë lekë;
- Obligacionet qeveritare 2-vjeçare…….	1 002 milionë lekë;
B. Të ardhura nga privatizimi…….	485 milionë lekë;
C. Të tjera…….	1 316 milionë lekë;
- Ndryshimi i gjendjes së arkës……	832 milionë lekë;
- Të tjera……	484 milionë lekë;
Financimi i jashtëm neto…… nga i cili:	20 647 milionë lekë;
Mbështetje buxhetore…….	4 349 milionë lekë.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.4006, datë 13.11.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

L I G J
Nr.9147, datë 30.10.2003

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS NR.155 TË ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË PUNËS "PËR SIGURINË NË PUNË, SHËNDETIN DHE MJEDISIN E PUNËS, 1981"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet Konventa nr.155 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës "Për sigurinë në punë, shëndetin dhe mjedisin e punës, 1981".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.4007, datë 18.11.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

KONVENTË NR.155

KONVENTË
MBI SIGURINË NË PUNË, SHËNDETIN DHE AMBIENTIN E PUNËS[1]

Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës:

mbledhur në Gjenevë nga organi drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës dhe duke u mbledhur në sesionin e 67-të, më 3 qershor 1981;

duke vendosur për miratimin e propozimeve të caktuara në lidhje me sigurinë, shëndetin dhe ambientin e punës, e cila është çështja e gjashtë në rendin e ditës të sesionit;

duke vendosur që këto propozime marrin formën e një konvente ndërkombëtare,

miraton më 22 qershor të vitit 1981, Konventën e mëposhtme, e cila mund të citohet si Konventa për shëndetin dhe sigurinë në punë, 1981.

PJESA I. FUSHA E ZBATIMIT DHE PËRKUFIZIME

Neni 1

1. Konventa zbatohet në të gjitha degët e aktivitetit ekonomik.

[1] Data e hyrjes në fuqi 11 gusht 1983

2. Një anëtar që ratifikon këtë Konventë, pas konsultimeve në momentin më të parë të mundur me organizatat përfaqësuese të punëdhënësve dhe punëtorëve të interesuar, mund të përjashtojë nga zbatimi, pjesërisht ose tërësisht, degë të veçanta të aktivitetit ekonomik, si transportin detar ose peshkimin, në lidhje me të cilat lindin probleme të veçanta të një natyre lëndore.

3. Çdo shtet anëtar që ratifikon këtë Konventë, në raportin e parë mbi zbatimin e Konventës, të paraqitur sipas nenit 22 të Kushtetutës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës, bën një listë për të gjitha degët që mund të jenë përjashtuar, në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, duke dhënë arsyet për këtë përjashtim dhe duke përshkruar masat e marra për të bërë një mbrojtje të përshtatshme të punëtorëve në degët e përjashtuara dhe në raportet pasuese tregon në lidhje me përparimin e bërë për një zbatim më të gjerë.

Neni 2

1. Kjo Konventë zbatohet për të gjithë punëtorët në degët e aktivitetit ekonomik që mbulohen.

2. Një anëtar që ratifikon këtë Konventë, pas konsultimeve në momentin më të parë të mundur me organizatat përfaqësuese të punëdhënësve dhe punëtorëve të interesuar, mund të përjashtojë nga zbatimi i saj, pjesërisht ose tërësisht, kategori të kufizuara të punëtorëve në lidhje me të cilët ka vështirësi të veçanta.

3. Çdo anëtar që ratifikon këtë Konventë, në raportin e parë mbi zbatimin e Konventës të paraqitur sipas nenit 22 të Kushtetutës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës, bën një listë me të gjitha kategoritë e kufizuara të punëtorëve që mund të jenë përjashtuar në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, duke paraqitur arsyet e përjashtimit, dhe në raportet e mëvonshme tregon çdo përparim të bërë drejt një zbatimi më të gjerë.

Neni 3

Për qëllimet e kësaj Konvente:

a) Termi "degë e aktivitetit ekonomik" mbulon të gjitha degët ku punësohen punëtorë, duke përfshirë edhe shërbimin publik.

b) Termi "punëtorë" mbulon të gjithë personat e punësuar, duke përfshirë punonjësit e shërbimit publik.

c) Termi "vend pune" mbulon të gjitha vendet ku punëtorët duhet të jenë ose duhet të shkojnë për qëllimet e punës dhe që janë nën kontrollin e drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë të punëdhënësit.

d) Termi "rregullore" mbulon të gjitha dispozitat, që u jepet fuqia e ligjit nga organi ose organet kompetente.

e) Termi "shëndet", në lidhje me punën, nuk tregon vetëm mungesën e sëmundjes ose dobësisë; ai përfshin, gjithashtu, elementet fizike dhe mendore që influencojnë shëndetin dhe që kanë të bëjnë direkt me sigurinë dhe higjienën në punë.

PJESA II. PRINCIPET E POLITIKËS KOMBËTARE

Neni 4

1. Çdo anëtar, nën dritën e kushteve dhe praktikave ndërkombëtare dhe në konsultim me organizatat me përfaqësues të punëdhënësve dhe punëtorëve formulon, zbaton dhe rishikon periodikisht politikën kombëtare të kohës mbi sigurinë në punë, shëndetin në punë dhe ambientin e punës.

2. Qëllimi i politikës është parandalimi i aksidenteve dhe i dëmtimit të shëndetit që shkaktohen, kanë të bëjnë ose ndodhin në punë e sipër, duke minimizuar, aq sa është praktikisht e arsyeshme, shkaqet e rreziqeve që janë në ambientin e punës.

Neni 5

Politika e përmendur në nenin 4 të kësaj Konvente merr parasysh sferat kryesore të mëposhtme të veprimit, për aq sa ato kanë të bëjnë me sigurinë dhe shëndetin në punë dhe me ambientin e punës:

a) projektimin, provimin, zgjedhjen, zëvendësimin, instalimin, rregullimin, përdorimin dhe mirëmbajtjen e elementeve materiale të punës (vendet e punës, ambientin e punës, veglat, makineritë dhe pajisjet, substancat dhe agjentët kimikë, fizikë dhe biologjikë, proceset e punës);

b) raportet ndërmjet elementeve materiale të punës dhe personave që kryejnë ose mbikëqyrin punën dhe përshtatjen e makinerive, pajisjeve, kohës së punës, organizimin e punës dhe proceset e punës, aftësive fizike dhe mendore të punëtorëve;

c) kualifikimin, duke përfshirë kualifikimin e mëtejshëm të nevojshëm, aftësitë dhe motivimet e personave përkatës, në çdo cilësi, në arritjen e niveleve të përshtatshme të sigurisë dhe të shëndetit;

d) komunikimin dhe bashkëpunimin në të gjitha nivelet e grupit të punës dhe ndërmarrjen në të gjitha nivelet e tjera të përshtatshme, deri tek dhe duke përfshirë nivelin kombëtar;

e) mbrojtjen e punëtorëve dhe përfaqësuesve të tyre nga masat disiplinore si rezultat i veprimeve të ndërmarra prej tyre në pajtim me politikën e përmendur në nenin 4 të kësaj Konvente.

Neni 6

Formulimi i politikës së përmendur në nenin 4 të kësaj Konvente tregon funksionet dhe përgjegjësitë përkatëse në lidhje me sigurinë dhe shëndetin në punë dhe ambientin e punës së organeve publike, punëdhënësve, punëtorëve dhe të tjerëve, duke marrë parasysh karakterin plotësues të këtyre përgjegjësive dhe të kushteve dhe praktikës kombëtare.

Neni 7

Situata, në lidhje me sigurinë dhe shëndetin në punë dhe ambientin e punës, rishikohet në periudha të përshtatshme kohore, e gjitha ose në lidhje me sfera të veçanta, me qëllimin e identifikimit të problemeve madhore, marrjen e masave të efektshme për trajtimin e tyre dhe të prioriteteve të veprimit dhe vlerësimin e rezultateve.

PJESA III. VEPRIMI NË NIVEL KOMBËTAR

Neni 8

Çdo anëtar me ligj ose rregullore, ose ndonjë mënyrë tjetër që përputhet me kushtet dhe praktikat kombëtare, dhe në konsultim me organizatat përfaqësuese të punëdhënësve dhe punëtorëve të interesuar, ndërmarrin ato hapa që janë të nevojshëm për t'i dhënë fuqi nenit 4 të kësaj Konvente.

Neni 9

1. Zbatimi i ligjeve dhe rregulloreve, në lidhje me sigurinë dhe shëndetin në punë dhe ambientin e punës, sigurohet nëpërmjet një sistemi të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm inspektimi.

2. Sistemi i zbatimit parashikon dënime të mjaftueshme për shkeljet e ligjeve dhe rregulloreve.

Neni 10

Merren masa për të orientuar punëdhënësit dhe punëtorët për t'i ndihmuar ata të përmbushin detyrimet ligjore.

Neni 11

Për t'i dhënë fuqi politikës së përmendur në nenin 4 të kësaj Konvente, organi ose organet kompetente sigurojnë që funksionet e mëposhtme të zbatohen në mënyrë progresive:

a) përcaktimi i kushteve, kur kjo kërkohet nga natyra dhe shkalla e rrezikut, që rregullojnë projektimin, ndërtimin dhe paraqitjen e sipërmarrjeve, fillimin e operacioneve të tyre, ndryshimet madhore që kanë efekt mbi to dhe ndryshimet në qëllimet e tyre, sigurinë e pajisjeve teknike që përdoren në punë, si dhe zbatimin e procedurave të përcaktura nga organet kompetente;

b) përcaktimi i proceseve të punës dhe i substancave dhe agjentëve, ekspozimi karshi të cilave ndalohet, kufizohet ose i nënshtrohet autorizimit, ose kontrollit nga organi ose organet kompetente; rreziqet për shëndetin për shkak të ekspozimit të njëkohshëm karshi disa substancave dhe agjentëve merren parasysh;

c) përcaktimi dhe zbatimi i procedurave për njoftimin e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale nga punëdhënësit dhe, sipas rastit, nga institutet e sigurimeve dhe subjekte të tjera që janë drejtpërdrejt të interesuara dhe përpilimin e statistikave vjetore mbi aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale;

d) kryerja e hetimeve kur rastet e aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale ose dëmtime të tjera të shëndetit që janë shkaktuar në punë e sipër ose në lidhje me punën, duket se paraqesin situata serioze;

e) botimin çdo vit të informacionit mbi masat e marra në pajtim me politikën e përmendur në nenin 4 të kësaj Konvente dhe mbi aksidentet në punë, sëmundjet profesionale dhe dëmtime të tjera të shëndetit që shkaktohen në punë e sipër ose në lidhje me punën;

f) prezantimi ose zgjerimi i sistemeve, duke marrë parasysh kushtet dhe mundësitë kombëtare për ekzaminimin e agjentëve kimikë, fizikë dhe biologjikë, në lidhje me rrezikimin e shëndetit të punëtorëve.

Neni 12

Merren masa, në pajtim me ligjin dhe praktikën kombëtare, me qëllim që të sigurohet se ata që projektojnë, prodhojnë, importojnë, furnizojnë ose transferojnë makineri, pajisje ose substanca për përdorim profesional:

a) të jenë të bindur që, për aq sa është praktike në mënyrë të arsyeshme, makineria, pajisja ose substanca nuk përbën rrezik për sigurinë dhe shëndetin e atyre që i përdorin ato rregullisht;

b) të bëjnë të ditur informacionin në lidhje me instalimin e rregullt dhe përdorimin e makinerisë dhe pajisjes dhe përdorimin e rregullt të substancës, informacionin mbi rreziqet e makinerisë dhe pajisjes dhe cilësitë e dëmshme të substancave kimike dhe të agjentëve fizikë ose biologjikë, ose produkteve, si dhe udhëzime se si mund të mënjanohen rreziqet;

c) të ndërmarrë studime dhe kërkime ose të jetë në korrent me njohuritë shkencore dhe teknike të nevojshme për të respektuar nënparagrafët (a) dhe (b) të këtij neni.

Neni 13

Një punëtor, që është larguar nga një ambient pune për të cilin ai ka justifikim të mjaftueshëm për të besuar se përbën një rrezik të drejtpërdrejtë dhe serioz për jetën ose shëndetin e tij, mbrohet nga pasojat e rënda në pajtim me kushtet dhe praktikën kombëtare.

Neni 14

Merren masa që, në mënyrën e përshtatshme për kushtet dhe praktikën kombëtare, të nxitet përfshirja e çështjeve të sigurisë dhe shëndetit në punë dhe e ambientit të punës në të gjitha nivelet e arsimit dhe kualifikimit, duke përfshirë arsimin e lartë teknik, mjekësor dhe profesional, në një mënyrë që të përmbushen nevojat për kualifikim të të gjithë punëtorëve.

Neni 15

1. Me qëllim që të sigurohet koherenca e politikës së përmendur në nenin 4 të kësaj Konvente dhe e masave në zbatim të saj, çdo anëtar, pas konsultimeve në momentin më të parë të mundur me organizatat me përfaqësues të punëdhënësve dhe punëtorëve dhe me organe të tjera sipas rastit, merr masa që u përshtaten kushteve dhe praktikave kombëtare, për të siguruar koordinimin e nevojshëm

ndërmjet organeve dhe autoriteteve të ndryshme që kërkohen për t'u dhënë fuqi pjesëve II dhe III të kësaj Konvente.

2. Kurdoherë që kërkohet nga rrethanat dhe lejohet nga kushtet dhe praktikat kombëtare, këto masa përfshijnë krijimin e një organi qendror.

PJESA IV. VEPRIMI NË NIVELIN E NDËRMARRJES

Neni 16

1. Punëdhënësve u kërkohet të sigurojnë që, për aq sa është praktike në mënyrë të arsyeshme, vendet e punës, makineritë, pajisjet dhe proceset nën kontrollin e tyre të jenë të sigurta dhe pa rrezik për shëndetin.

2. Punëdhënësve u kërkohet të sigurojnë që, për aq sa është praktike në mënyrë të arsyeshme, substancat dhe agjentët kimikë, fizikë dhe biologjikë nën kontrollin e tyre të jenë pa rrezik për shëndetin, nëse merren masat e përshtatshme për mbrojtjen.

3. Punëdhënësve u kërkohet, kur është e nevojshme, të japin veshje të përshtatshme mbrojtëse dhe pajisje mbrojtëse, për aq sa është praktike në mënyrë të arsyeshme, për të parandaluar rreziqet e aksidenteve ose efektet e dëmshme për shëndetin.

Neni 17

Kur dy ose më shumë ndërmarrje përfshihen në aktivitete në të njëjtin vend pune, ato bashkëpunojnë në zbatimin e kërkesave të kësaj Konvente.

Neni 18

Punëdhënësve u kërkohet, kur është e nevojshme, të parashikojnë masat në trajtimin e urgjencave dhe aksidenteve, duke përfshirë dhe masat për ndihmën e shpejtë.

Neni 19

Në nivelin e ndërmarrjes merren masa që:

a) gjatë kryerjes së punës, punëtorët të bashkëpunojnë për plotësimin nga punëdhënësi të detyrimeve që ai u nënshtrohet;

b) përfaqësuesit e punëtorëve në ndërmarrje të bashkëpunojnë me punëdhënësin në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë;

c) përfaqësuesve të punëtorëve në një ndërmarrje u jepet informacion i mjaftueshëm mbi masat e marra nga punëdhënësit për të garantuar sigurinë dhe shëndetin në punë dhe mund të konsultohen me organizatat e tyre përfaqësuese mbi këtë informacion, me kusht që të mos nxjerrin sekrete tregtare;

d) punëtorët dhe përfaqësuesit e tyre në ndërmarrje të marrin kualifikim të përshtatshëm për sigurinë dhe shëndetin në punë;

e) punëtorëve ose përfaqësuesve të tyre, sipas rastit, organizatave të tyre përfaqësuese në një ndërmarrje, në pajtim me ligjin dhe praktikën kombëtare, u jepet mundësia të hetojnë dhe të konsultohen nga punëdhënësi për të gjitha aspektet e sigurisë dhe shëndetit në punë që ka të bëjë me aktivitetin e tyre; për këtë qëllim mund të sillen me marrëveshje reciproke, këshilltarë teknikë nga jashtë ndërmarrjes;

f) një punëtor i raporton menjëherë mbikëqyrësit të tij, në lidhje me çdo situatë për të cilën ai ka justifikim të arsyeshëm të besojë se përbën një rrezik të drejtpërdrejtë dhe serioz për jetën dhe shëndetin e tij; derisa punëdhënësi, nëse është e nevojshme, nuk ka marrë ndonjë masë përmirësuese, punëdhënësi nuk mund t'u kërkojë punëtorëve të kthehen në një ambient pune ku vazhdon të mbetet rreziku i drejtpërdrejtë dhe serioz për jetën ose shëndetin.

Neni 20

Bashkëpunimi ndërmjet menaxhimit dhe punëtorëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre brenda ndërmarrjes është element thelbësor i masave organizative ose të tjera që merren në pajtim me nenet 16-19 të kësaj Konvente.

Neni 21

Masat për sigurinë dhe shëndetin në punë nuk shkaktojnë ndonjë shpenzim nga ana e punëtorëve.

PJESA V. DISPOZITA E FUNDIT

Neni 22

Kjo Konventë nuk ndryshon asnjë konventë ose rekomandim ndërkombëtar për punën.

Neni 23-30
Dispozitat standarde të fundit

LIDHJA 1
DISPOZITAT STANDARDE TË FUNDIT

1. Ratifikimet

Ratifikimet formale të kësaj Konvente i njoftohen Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës për regjistrim.

2. Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë është detyruese për ata anëtarë të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, ratifikimet e të cilëve janë regjistruar nga drejtori i përgjithshëm.

2. Ajo hyn në fuqi 12 muaj pas datës në të cilën janë regjistruar ratifikimet e dy anëtarëve nga drejtori i përgjithshëm.

3. Pas kësaj, kjo Konventë hyn në fuqi për çdo anëtar 12 muaj pas datës në të cilën është regjistruar ratifikimi i tij.

3. Denoncimi

1. Një anëtar që ka ratifikuar këtë Konventë mund t'a denoncojë atë pasi të kenë kaluar 10 vjet nga data në të cilën Konventa ka hyrë në fuqi për herë të parë, me anë të një akti drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës për regjistrim. Ky denoncim nuk hyn në fuqi pa kaluar një vit nga data në të cilën ai është regjistruar.

2. Çdo anëtar që ka ratifikuar këtë Konventë dhe që nuk e ushtron të drejtën e denoncimit të parashikuar në këtë nen brenda një viti pas kalimit të periudhës dhjetëvjeçare, të përmendur në paragrafin e mësipërm, i nënshtrohet asaj për një periudhë tjetër dhjetëvjeçare dhe pas kësaj mund t'a denoncojë këtë Konventë pas skadimit të çdo periudhe dhjetëvjeçare sipas kushteve të parashikuara në këtë nen.

4. Njoftimi i ratifikimeve për anëtarët

1. Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës njofton të gjithë anëtarët e Organizatës Ndërkombëtare të Punës për regjistrimin e të gjitha ratifikimeve dhe denoncimeve që i drejtohen atij nga anëtarët e organizatës.

2. Kur njofton anëtarët e organizatës për regjistrimin e ratifikimit të dytë që i është drejtuar atij, drejtori i përgjithshëm u tërheq vëmendjen anëtarëve të organizatës në lidhje me datën në të cilën Konventa hyn në fuqi.

5. Njoftimi i Kombeve të Bashkuara

Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës i njofton Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për regjistrim, në pajtim me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara të gjitha hollësitë e të gjitha ratifikimeve dhe akteve të denoncimit të regjistruara prej tij, në pajtim me dispozitat e neneve të mësipërme.

Shënim: Kjo dispozitë nuk është në konventat nr.1-67.

6. Shqyrtimi i rishikimit

Në momentin që i duket e nevojshme, organi drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës i paraqet, konferencës së përgjithshme një raport mbi mbarëvajtjen e kësaj Konvente dhe shqyrton dëshirueshmërinë e futjes së çështjes së rishikimit të saj në rendin e ditës së konferencës plotësisht ose pjesërisht.

Shënim: Në konventat nr.1-98 kjo dispozitë, fillimisht, parashikonte raporte nga organi drejtues edhe dhjetë vjet pas hyrjes në fuqi. Ajo u zëvendësua në këto konventa nga ky tekst, sipas kushteve të konventës për rishikimin e neneve të fundit, 1961, (nr.116).

7. Efekti i rishikimit të Konventës

1. Nëse konferenca aprovon një konventë të re duke ndryshuar këtë Konventë plotësisht ose pjesërisht, atëherë nëse konventa e re nuk parashikon ndryshe:

a) ratifikimi nga një anëtar i konventës së re të rishikuar sjell *ipso jure* denoncimin e menjëhershëm të kësaj Konvente, në ndryshim nga dispozitat e nenit 3 të mësipërm, nëse dhe kur konventa e re e rishikuar do të ketë hyrë në fuqi.

b) që nga data kur Kushtetuta e re e rishikuar hyn në fuqi, kjo Konventë pushon së qeni e hapur për ratifikimin nga anëtarët.

2. Kjo Konventë qëndron në fuqi për çdo rast me këtë formë dhe përmbajtje për ata anëtarë që e kanë ratifikuar atë, por nuk kanë ratifikuar konventën e rishikuar.

Shënim: Kjo dispozitë nuk është në konventat nr.1-26. Konventat nr.27-33 nuk përmbajnë fjalën "atëherë, nëse konventa e re nuk e parashikon ndryshe".

8. Tekstet autentike

Versionet e tekstit në anglisht dhe frëngjisht të kësaj Konvente janë njëlloj autentike.

Shënim: Në konventat nr.1-67 kjo dispozitë thotë: "Tekstet në frëngjisht dhe anglisht të kësaj Konvente janë të dyja autentike".

L I G J
Nr.9148, datë 30.10.2003

PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT TË VITIT 2002 TË KONVENTËS NR.155 TË ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË PUNËS "PËR SIGURINË NË PUNË, SHËNDETIN DHE MJEDISIN E PUNËS, 1981"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet Protokolli i vitit 2002 i Konventës nr.155 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës "Për sigurinë në punë, shëndetin dhe mjedisin e punës, 1981".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.4008, datë 18.11.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

PROTOKOLL
PËR KONVENTËN E SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PUNË, 1981

Konferenca e përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës:

duke u mbledhur në Gjenevë nga organi drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës dhe duke zhvilluar sesionin e 90-të më, 3 korrik 2002;

duke parë dispozitat e nenit 11 të Konventës së sigurisë dhe shëndetit në punë, 1981 (tani e tutje quhet "Konventa"), e cila parashikon në mënyrë të veçantë:

"Për zbatimin e politikës së përmendur në nenin 4 të Konventës, organi ose organet kompetente sigurojnë që funksionet e mëposhtme të kryhen në mënyrë progresive:

…

c) caktimi dhe zbatimi i procedurave për njoftimin e aksidenteve dhe të sëmundjeve profesionale nga punëdhënësit dhe, kur është e përshtatshme, nga institutet e sigurimeve dhe subjekteve të tjera të interesuara drejtpërdrejt, si dhe hartimi i statistikave vjetore, në lidhje me aksidentet dhe sëmundjet profesionale;

e) botimi çdo vit i informacionit mbi masat e marra në pajtim me politikën e përmendur në nenin 4 të kësaj Konvente dhe mbi aksidentet në punë, sëmundjet profesionale dhe dëmtimet e tjera të shëndetit që janë shkaktuar gjatë ose në lidhje me punën";

duke pasur parasysh nevojën e forcimit të procedurave të regjistrimit dhe njoftimit për aksidentet dhe sëmundjet profesionale dhe nxitjes së harmonizimit të sistemit të regjistrimit me qëllimin e identifikimit të shkaqeve të tyre dhe marrjen e masave parandaluese;

duke vendosur për aprovimin e propozimeve të caktuara në lidhje me regjistrimin dhe njoftimin e aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale, që është pika e pestë e punimeve të sesionit;

duke vendosur që këto propozime të marrin formën e një protokolli të Konventës për sigurinë dhe shëndetin në punë, 1981,

aprovon më 20 qershor 2002 protokollin e mëposhtëm, i cili mund të citohet si protokolli i vitit 2002 i Konventës së sigurisë dhe shëndetit në punë, 1981.

I. PËRKUFIZIME

Neni 1

Për qëllimin e këtij protokolli:

a) Termi "aksident në punë" mbulon një ndodhi që shkaktohet nga ose gjatë punës, e cila mund të rezultojë në dëmtim fatal ose jofatal.

b) Termi "sëmundje profesionale" mbulon çdo sëmundje që shkaktohet si rezultat i ekspozimit karshi rreziqeve që rrjedhin nga aktiviteti i punës.

c) Termi "ndodhi e rrezikshme" mbulon një ngjarje lehtësisht të identifikueshme sipas përkufizimit të ligjeve dhe rregulloreve vendase, me potencialin për t'i shkaktuar një dëmtim ose sëmundje një personi në punë ose publikut.

d) Termi "aksident në rrugë" mbulon një aksident që shkakton vdekjen ose dëmtimin e personit, që ndodh në rrugën ndërmjet vendit të punës dhe

i) vendbanimit të parë ose të dytë të punëtorit;

ii) vendit ku punëtori zakonisht ushqehet;

iii) vendit ku punëtori zakonisht merr pagesën e tij ose të saj.

II. SISTEMET E REGJISTRIMIT DHE NJOFTIMIT

Neni 2

Organi kompetent, me anë të ligjeve dhe rregulloreve ose ndonjë metodë tjetër në pajtim me kushtet dhe praktikat vendase dhe në konsultim me organizatat me përfaqësues të punëdhënësve dhe punëtorëve, përcaktojnë dhe rishikojnë periodikisht kërkesat dhe procedurat për:

a) regjistrimin e aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale dhe, sipas rastit, ndodhitë e rrezikshme, aksidentet në rrugë dhe rastet e dyshuara të sëmundjeve profesionale;

b) njoftimin e aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale dhe, sipas rastit, ndodhitë e rrezikshme, aksidentet në rrugë dhe rastet e dyshuara të sëmundjeve profesionale.

Neni 3

Kërkesat dhe procedurat për regjistrimin rregullojnë:

a) përgjegjësinë e punëdhënësit për:

i) regjistrimin e aksidenteve në punë, sëmundjeve profesionale dhe, sipas rastit, ndodhitë e rrezikshme, aksidentet në rrugë dhe rastet e dyshuara të sëmundjeve profesionale;

(ii) dhënien e informacionit të përshtatshëm punëtorëve dhe përfaqësuesve të tyre në lidhje me sistemin e regjistrimit;

(iii) sigurimin e mbajtjes së përshtatshme të këtyre të dhënave dhe përdorimin e tyre për marrjen e masave parandaluese;

(iv) mënjanimin e marrjes së masave hakmarrëse ose disiplinore kundër një punëtori që raporton një aksident në punë, sëmundje profesionale, ndodhi të rrezikshme, aksident në rrugë ose rast të dyshuar të sëmundjes profesionale;

b) informacionin që duhet të regjistrohet;

c) periudhën e mbajtjes së këtyre të dhënave;

d) masat për të siguruar konfidencialitetin e të dhënave personale dhe mjekësore në zotërim të punëdhënësit, në pajtim me ligjet dhe rregulloret, kushtet dhe praktikat vendase.

Neni 4

Kërkesat dhe procedurat për njoftimin parashikojnë:

a) përgjegjësinë e punëdhënësve për:

i) njoftimin e organeve kompetente ose organeve të tjera të caktuara në lidhje me aksidentet në punë, sëmundjet profesionale dhe, sipas rastit, ndodhitë e rrezikshme, aksidentet në rrugë dhe rastet e dyshuara të sëmundjeve profesionale dhe

ii) dhënien e informacionit të përshtatshëm punëtorëve dhe përfaqësuesve të tyre në lidhje me rastet e njoftuara;

b) kur është rasti, masat për njoftimin e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale nga institutet e sigurimeve, shërbimet mjekësore në punë, mjekët dhe organe të tjera që janë drejtpërdrejt të interesuara;

c) kriteret sipas së cilave duhet të njoftohen aksidentet në punë, sëmundjet profesionale dhe, sipas rastit, ndodhitë e rrezikshme, aksidentet në rrugë dhe rastet e dyshuara të sëmundjeve profesionale;

d) afatet e njoftimit.

Neni 5

Njoftimi përfshin të dhëna mbi:

a) ndërmarrjen, subjektin ose punëdhënësin;

b) nëse është e zbatueshme, personat e dëmtuar dhe natyrën e dëmtimeve ose sëmundjes;

c) vendin e punës, rrethanat e aksidentit ose ndodhinë e rrezikshme dhe, në rastin e një sëmundjeje profesionale, rrethanat e ekspozimit karshi rrezikimit të shëndetit.

III. STATISTIKAT KOMBËTARE

Neni 6

Çdo shtet anëtar që ratifikon këtë protokoll, bazuar mbi njoftimet dhe informacionin tjetër të disponueshëm, boton çdo vit statistika, të cilat përpilohen në mënyrë të tillë që të përfaqësojnë të gjithë vendin në lidhje me aksidentet në punë, sëmundjet profesionale dhe, sipas rastit, ndodhitë e rrezikshme dhe aksidentet në rrugë, si dhe një analizë të tyre.

Neni 7

Statistikat përpilohen në pajtim me skemat e klasifikimit, që janë në pajtim me skemat përkatëse të fundit, ndërkombëtare, që janë përpiluar nën kujdesin e Organizatës Ndërkombëtare të Punës ose organizata të tjera ndërkombëtare.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 8

1. Një anëtar mund ta ratifikojë këtë protokoll në të njëjtën kohë ose në çdo moment pas ratifikimit të Konventës, duke ia njoftuar ratifikimin formal Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës për regjistrimin.

2. Protokolli hyn në fuqi 12 muaj pas datës në të cilën janë regjistruar ratifikimet për dy anëtarë nga drejtori i përgjithshëm. Pas kësaj, për një anëtar ky protokoll hyn në fuqi 12 muaj pas datës së regjistrimit të ratifikimit nga drejtori i përgjithshëm dhe Konventa është detyruese për anëtarin përkatës, duke shtuar edhe nenet 1 deri 7 të këtij protokolli.

Neni 9

1. Një anëtar që ka ratifikuar këtë protokoll mund ta denoncojë atë kurdoherë që Konventa është e hapur për t'u denoncuar sipas nenit 25, nëpërmjet një akti drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës për regjistrim.

2. Denoncimi i Konventës sipas nenit 25 të saj nga një anëtar që ka ratifikuar këtë protokoll shkakton *ipso jure* denoncimin e këtij protokolli.

3. Çdo denoncim i këtij protokolli, në pajtim me paragrafët 1 ose 2 të këtij neni, nuk hyn në fuqi deri një vit pas datës në të cilën është regjistruar.

Neni 10

1. Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës njofton të gjithë anëtarët e Organizatës Ndërkombëtare të Punës për regjistrimin e të gjitha verifikimeve dhe akteve të denoncimit të njoftuar nga anëtarët e organizatës.

2. Kur bën njoftimin e anëtarëve të organizatës në lidhje me regjistrimin e ratifikimit të dytë, drejtori i përgjithshëm tërheq vëmendjen e anëtarëve të organizatës për datën kur ky protokoll hyn në fuqi.

Neni 11

Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës njofton Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, në lidhje me regjistrimin sipas nenit 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, të gjitha hollësitë e ratifikimeve dhe akteve të denoncimit të regjistruara nga drejtori i përgjithshëm sipas dispozitave të neneve të mësipërme.

Neni 12

Versionet e tekstit në anglisht dhe frëngjisht të këtij protokolli janë njësoj autentike.

Teksti i mësipërm është teksti autentik i protokollit, i miratuar rregullisht nga konferenca e përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës gjatë sesionit të 90, të mbajtur në Gjenevë dhe deklaruar e mbyllur më 20 qershor 2002.

Në dëshmi të kësaj, ne i vumë firmat tona më 21.6.2002.

L I G J
Nr.9149, datë 30.10.2003

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8310, DATË 19.3.1998 "PËR SIGURINË NË AVIACIONIN CIVIL SHQIPTAR"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8310, datë 19.3.1998 "Për sigurinë në aviacionin civil shqiptar", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3 "Përcaktimi i përgjegjësive" bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

"Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil (DPAC) është autoriteti përgjegjës për sigurinë e aviacionit civil në Republikën e Shqipërisë dhe për funksionimin e Komitetit të Sigurisë së Aviacionit Civil".

b) Pas shkronjës "g", shtohen shkronjat "gj", "h" dhe "i" me këtë përmbajtje:

“gj) DPAC-ja përcakton kriteret e punësimit në sektorin e sigurisë së aviacionit civil dhe miraton emërimin e punonjësve në këtë sektor.

h) DPAC-ja përgatit programet e trajnimit, të kualifikimit, të testimit dhe të certifikimit të punonjësve të sigurisë.

i) DPAC-ja, në marrëveshje me Ministrinë e Rendit Publik, përgatit programet e trajnimit, të kualifikimit, të testimit dhe të certifikimit të punonjësve të policisë dhe të doganave, për sigurinë në aeroport.".

Neni 2

Neni 11 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 11

Objekti i veprimtarisë së organit të Policisë së Shtetit, në përputhje me sigurinë në aviacionin civil, janë zbulimi, parandalimi dhe goditja e akteve kriminale, në veçanti të terrorizmit, të cilat mund të përbëjnë rrezik, si dhe parandalimi i incidenteve të rënda e i rasteve të jashtëzakonshme.".

Neni 3

Neni 12 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 12

Ministri i Rendit Publik është përgjegjës për përcaktimin e funksionit dhe të veprimtarisë së Policisë së Shtetit, për ruajtjen dhe sigurinë në aviacionin civil në aeroportet kombëtare dhe ndërkombëtare të vendit, nga aktet kriminale në përgjithësi dhe ato terroriste në veçanti dhe nga veprimet e tjera të paligjshme.".

Neni 4

Në nenin 13, pas shkronjës "c" shtohet shkronja "ç" me këtë përmbajtje:

"ç. Evidentimi, zbulimi dhe ndalimi i personave në kërkim, që kanë kryer vepra penale, i personave që kanë kryer vepra terroriste ose dyshohen se i kanë kryer ato.".

Neni 5

Neni 16 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 16

Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit dhe Ministria e Rendit Publik, në bashkëpunim me organizmat ndërkombëtarë të sigurisë dhe me shtetet e tjera, bashkërendojnë punën për sigurimin e aviacionit civil e të mjeteve fluturuese të tyre, për transport publik dhe jopublik, në bazë të marrëveshjeve dypalëshe.".

Neni 6

Në nenin 21, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

"3. Punonjësit, që punojnë në aeroport, pajisen me leje hyrje vjetore ose të përkohshme, të prodhuar nga sektori i sigurisë së aeroportit. Formati dhe modeli përcaktohen dhe miratohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Aviacionit Civil, me rekomandim të Komitetit të Sigurisë. Lista e këtyre punonjësve, para pajisjes me leje hyrje, kontrollohet nga shefi i Komisariatit të Policisë së aeroportit dhe miratohet nga DPCA-ja.".

Neni 7

Shkronja "b" e nenit 23 ndryshohet si më poshtë:

"b) kërkesat me shkrim të jenë të verifikuara edhe nga organi i Policisë së Shtetit, për të siguruar se ekzistojnë kushte për të lëshuar lejen.".

Neni 8

Në pikën 1 të nenit 24, pas shkronjës "ç" shtohet shkronja "d" me këtë përmbajtje:

"d) personin përgjegjës, që lëshon lejen me vulën përkatëse.".

Neni 9

Neni 30 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 30

1. Strukturat e sigurisë së aeroportit, në përputhje me strukturat e organizimit të veprimtarisë së tyre ligjore, ngarkohen për të kryer procesin e kontrollit të pasagjerëve, të mallrave dhe të postës, duke përfshirë atë të ekranizimit me rreze X dhe me dedektorë të ndryshëm.

2. Organi doganor, në përputhje me strukturat e organizimit të veprimtarisë së tij ligjore, ngarkohet të kryejë kontrollin financiar (kontroll parash), si dhe bagazhet, mallrat dhe postën, në hyrje dhe dalje.".

Neni 10

Në nenin 34 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"Brenda zonave tranzite ndalohet veprimtaria tregtare aeroportuale.".

Neni 11

Neni 71 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 71
Financimi

1. Për realizimin e infrastrukturës në aviacionin civil, me propozimin e DPAC-së, Ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit, në bashkëpunim me Ministrin e Financave, miraton tarifën për sigurinë në aviacionin civil.

2. Të ardhurat nga kjo tarifë ndahen në masën si më poshtë:
a) 25 për qind për DPAC-në;
b) 75 për qind për sektorin e sigurisë.".

Neni 12

Në të gjithë tekstin e ligjit fjalët "Ministria e Brendshme" dhe "Ministria e Punëve Publike dhe Transporteve" bëhen "Ministria e Rendit Publik" dhe "Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit".

Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.4009, datë 18.11.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

L I G J
Nr.9150, datë 30.10.2003

PËR URDHRIN E FARMACISTËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

1. Për ruajtjen e cilësisë së lartë të shërbimit farmaceutik dhe për zbatimin e rregullave të moralit e të etikës profesionale farmaceutike, krijohet Urdhri i Farmacistëve.
2. Urdhri i Farmacistëve është ent publik, i cili përbëhet nga individët, që ushtrojnë profesionin e farmacistit në Republikën e Shqipërisë dhe përfaqëson interesat e tyre profesionalë në nivel partneriteti institucional.

Neni 2

1. Urdhri i Farmacistëve ka për mision ruajtjen dhe garantimin e nivelit të lartë të formimit dhe edukimit shkencor e profesional të farmacistëve, ushtrimin e profesionit, sipas kërkesave

shkencore, normave të etikës mjekësore e të Kodit të Deontologjisë Farmaceutike Shqiptare dhe mbrojtjen e pacientëve e të konsumatorëve nga kequshtrimet profesionale dhe shkeljet e normave të detyrueshme.

2. Në përmbushje të këtij misioni, Urdhri i Farmacistëve:

a) bën regjistrimin e farmacistëve në një regjistër të veçantë;

b) mbikëqyr zbatimin e detyrave profesionale, në përputhje me kërkesat e shkencave farmaceutike dhe të legjislacionit farmaceutik;

c) bashkëpunon me institucionet arsimore e shkencore për hartimin dhe planifikimin e programeve të formimit shkencor, të specializimit pasuniversitar dhe të kualifikimit të vazhdueshëm të farmacistëve;

ç) mbikëqyr zbatimin e kërkesave të Kodit të Deontologjisë Farmaceutike Shqiptare, në mbrojtje të interesave të pacientëve dhe të konsumatorëve;

d) jep dhe heq të drejtën vetjake për ushtrimin e këtij profesioni.

Neni 3

1. Urdhri i Farmacistëve mbikëqyr respektimin e të drejtave dhe detyrave të personave, që ushtrojnë profesionin e farmacistit në Republikën e Shqipërisë, sipas rregullave të Kodit të Deontologjisë Farmaceutike Shqiptare, për mbrojtjen e popullatës nga kequshtrimi i profesionit dhe cenimet e etikës farmaceutike, si dhe nga veprime të tjera që privojnë kujdesin e nevojshëm farmaceutik.

2. Urdhri i Farmacistëve mbron farmacistët nga veprimet arbitrare të administratës publike ose private për ushtrimin e profesionit.

Neni 4

1. Anëtarë të Urdhrit të Farmacistëve bëhen individët, shtetas shqiptarë, të diplomuar farmacistë në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, që pranojnë Kodin Deontologjik Farmaceutik Shqiptar dhe që e ushtrojnë këtë profesion në sektorin e prodhimit farmaceutik, të shërbimit dhe të shpërndarjes farmaceutike, ambulator e spitalor, publik dhe privat, ose në sektorë të tjerë të shëndetësisë.

2. Përjashtohen nga ky detyrim, por jo nga e drejta e anëtarësimit në Urdhrin e Farmacistëve, farmacistët funksionarë të administratës publike, për sa kohë që ata nuk ushtrojnë veprimtari të mirëfilltë profesionale farmaceutike.

Neni 5

Shtetasit e huaj, për ushtrimin e profesionit të farmacistit në sektorin farmaceutik të Republikës së Shqipërisë, janë të detyruar të anëtarësohen në Urdhrin e Farmacistëve, të njohin dhe të zbatojnë Kodin e Deontologjisë Farmaceutike Shqiptare, si dhe të gjitha aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë shërbimin farmaceutik dhe atë shëndetësor në Republikën e Shqipërisë.

Neni 6

1. Asnjë individ nuk mund ta ushtrojë profesionin e farmacistit në Republikën e Shqipërisë, pa qenë anëtar i Urdhrit të Farmacistëve.

2. Punëdhënësit në institucionet a ndërmarrjet shtetërore ose publike dhe në subjektet private ndalohen t'i punësojnë ata në kundërshtim me këtë dispozitë.

3. Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Farmacistëve përcakton kriteret për pranimin e farmacistëve në këtë urdhër.

Neni 7

Urdhri i Farmacistëve si institucion, gjatë kryerjes së detyrave, mban lidhje, sipas përkatësisë,

me Ministrinë e Shëndetësisë, me institucione të tjera, si dhe me institucione e organizma publikë ose jopublikë, në nivel qendror e vendor. Urdhri i Farmacistëve merr pjesë në hartimin e projektligjeve dhe të dokumenteve të rëndësishme të farmaceutikës shqiptare.

Neni 8

1. Urdhri i Farmacistëve ka buxhetin e vet, të cilin e administron në përputhje me rregullat financiare në fuqi.

2. Burimet financiare të Urdhrit të Farmacistëve janë:

a) kuotizacionet e anëtarëve;

b) tarifat e regjistrimit dhe të dhënies së të drejtës vetjake për ushtrimin e profesionit;

c) donacionet e ndryshme vendase dhe të huaja dhe të ardhura të tjera të ligjshme.

3. Të ardhurat e realizuara gjatë ushtrimit të veprimtarisë së vet, Urdhri i Farmacistëve i përdor për të përmbushur misionin e caktuar me këtë ligj.

KREU II
ORGANIZIMI DHE DREJTIMI

Neni 9

Organet kryesore të Urdhrit të Farmacistëve janë:

a) asambletë;

b) këshillat;

c) komisionet disiplinore;

ç) Komisioni i Regjistrimit dhe i Dhënies së të Drejtës së Ushtrimit të Profesionit.

Neni 10

1. Asambleja e Përgjithshme përbëhet nga anëtarët e këshillave rajonalë.

2. Asambleja e Përgjithshme zgjedh Këshillin Kombëtar. Zgjedhjet për Këshillin Kombëtar bëhen çdo 4 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje. Asambleja rajonale përbëhet nga tërësia e përfaqësuesve të anëtarëve të Urdhrit të Farmacistëve të qarkut. Asambleja rajonale zgjedh këshillin rajonal. Zgjedhjet e këshillit rajonal bëhen çdo 4 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

Neni 11

1. Në Këshillin Kombëtar bëjnë pjesë detyrimisht Presidenti i Urdhrit të Farmacistëve, zëvendësi i tij, presidentët e këshillave rajonalë, si dhe nga një përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë, Instituti i Sigurimit Shëndetësor dhe Fakulteti i Mjekësisë.

2. Asambleja e Përgjithshme zgjedh Presidentin dhe zëvendësin e tij me një mandat 4-vjeçar, me të drejtën e një rizgjedhjeje. Funksioni i Presidentit është i papajtueshëm me funksione të tjera drejtuese në administratën publike.

3. Këshilli Kombëtar emëron dhe shkarkon Sekretarin e Përgjithshëm.

4. Këshilli Kombëtar merr vendime, me shumicë votash, kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të vet.

Neni 12

Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Farmacistëve harton dhe miraton Kodin e Deontologjisë

Farmaceutike, si dhe statutin e Urdhrit të Farmacistëve.

Neni 13

Këshilli Kombëtar, në përputhje me misionin e Urdhrit të Farmacistëve, të parashikuar në dispozitat e këtij ligji, ka këto përgjegjësi:

a) përcakton e miraton strukturën organizative të këshillave rajonalë dhe të Këshillit Kombëtar;

b) cakton kuotizacionin dhe tarifën e regjistrimit;

c) administron pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të Urdhrit të Farmacistëve në nivel kombëtar, duke përcaktuar fondet në administrimin e këshillave rajonalë;

ç) mbikëqyr të gjitha veprimtaritë dhe administrimin e organeve që varen prej tij;

d) mbikëqyr dhe ndërhyn në rregullimin e marrëdhënieve të punës së farmacistëve dhe subjekteve të tyre private me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Institutin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.

Neni 14

1. Këshillat rajonalë krijohen sipas ndarjes administrative-territoriale.

2. Këshilli rajonal zgjedh presidentin dhe zëvendësin e vet. Mandati i presidentit është 4 vjet, me të drejtën e një rizgjedhjeje.

3. Këshilli rajonal emëron dhe shkarkon sekretarin.

Neni 15

Këshilli rajonal, nën mbikëqyrjen e Këshillit Kombëtar, në përmbushjen e misionit të Urdhrit të Farmacistëve, brenda juridiksionit të vet ka këto detyra:

a) mbikëqyr dhe ndërhyn në rregullimin e marrëdhënieve të punës ndërmjet farmacistëve, subjekteve të ndryshme private farmaceutike dhe atyre ndërinstitucionale në sektorin farmaceutik e shëndetësor të qarkut;

b) administron buxhetin dhe të gjitha pasuritë e Urdhrit të Farmacistëve të qarkut;

c) zbaton vendimet e Këshillit Kombëtar dhe rregulloret e udhëzimet e hartuara prej tij;

ç) cakton komisionin e regjistrimit të anëtarëve.

Neni 16

1. Pranë Këshillit Kombëtar dhe këshillave rajonalë të Urdhrit të Farmacistëve funksionojnë komisionet disiplinore, të cilat caktohen respektivisht nga Asambleja e Përgjithshme dhe ajo rajonale.

2. Komisionet disiplinore janë organe të gjykimit profesional, të cilat verifikojnë dhe shqyrtojnë ankesat për shkeljet e Kodit të Deontologjisë Farmaceutike, si dhe gabimet teknike të farmacistëve gjatë ushtrimit të profesionit.

3. Komisionet disiplinore, pranë këshillave rajonalë, ushtrojnë kompetenca disiplinore të shkallës së parë. Vendimet e tyre janë të apelueshme në komisionin disiplinor të Këshillit Kombëtar, i cili ushtron kompetenca disiplinore të shkallës së dytë.

Neni 17

1. Komisioni disiplinor heton dhe gjykon, në mbështetje të fakteve dhe provave të administruara në seancë dëgjimore. Kur vërteton se anëtari ka kryer shkelje të Kodit të Deontologjisë Farmaceutike ose ka bërë gabime teknike, ai jep njërën nga masat e mëposhtme:

a) vërejtje me shkrim;

b) vërejtje me paralajmërim;

c) gjobë nga 10 000 deri 200 000 lekë;

ç) shkarkim nga organet drejtuese të Urdhrit të Farmacistëve dhe heqje të së drejtës për t'u rizgjedhur në këto organe për një periudhë deri në 3 vjet;

d) përjashtim nga Urdhri i Farmacistëve për një periudhë deri në 3 vjet.

2. Komisioni ka të drejtë t'u caktojë kundërvajtësve, si masë plotësuese, kryerjen e një rikualifikimi në institucionet publike, sipas tarifave të përcaktuara.

3. Masat e mësipërme disiplinore vlerësohen të shlyera, në qoftë se brenda 1 viti nga dita e dhënies së tyre, për shkronjat "a" dhe "b" të këtij neni, dhe brenda 3 vjetëve për shkronjat "c" dhe "d", nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore ndaj anëtarit të Urdhrit të Farmacistëve.

Neni 18

1. Ankesat kundër vendimeve për marrjen e masave disiplinore nga komisioni disiplinor i këshillit rajonal paraqiten në komisionin disiplinor të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Farmacistëve brenda 30 ditëve nga komunikimi me shkrim i vendimit.

2. Komisioni disiplinor, brenda 30 ditëve nga marrja e ankesës, detyrohet të japë vendimin për ankesën e paraqitur. Vendimi i komisionit disiplinor të Këshillit Kombëtar është përfundimtar.

3. Për masat disiplinore, të parashikuara në shkronjat "c" dhe "d" të nenit 17 të këtij ligji, personi ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës brenda 30 ditëve nga data e komunikimit me shkrim të vendimit.

KREU III
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 19

1. Ministri i Shëndetësisë ngarkohet të ngrejë një komision të përkohshëm, i cili duhet të organizojë zgjedhjet e para të këshillave rajonalë dhe të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Farmacistëve.

2. Këto zgjedhje të bëhen brenda 3 muajve nga data e hyjes në fuqi të këtij ligji. Me zgjedhjen e Këshillit Kombëtar, komisioni i përkohshëm shkrihet.

Neni 20

Urdhri i Farmacistëve financohet nga shteti për një periudhë njëvjeçare. Masa dhe mënyra e këtij financimi përcaktohen me akte nënligjore, të nxjerra nga Këshilli i Ministrave.

Neni 21

Çdo dispozitë, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 22

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.4010, datë 18.11.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI TETOR 2003

1.	KUSHTETUTA	600
2.	PËRMBLEDHËSE NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
3.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
4.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
5.	KODI PENAL	400
6.	KODI I PUNËS	500
7.	KODI I FAMILJES	450
8.	KODI CIVIL	1000
9.	KODI RRUGOR	900
10.	KODI ZGJEDHOR	355
11.	PËRMBLEDHËSE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
12.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT DOGANOR	1500
13.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

Doli nga shtypi më 3.12.2003

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 100 lekë